



**KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2018 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI
PËR INFRASTRUKTURËN KOMUNALE V”**

➤ **HYRJE**

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin Z. Jovan Gjika, Drejtor i Projekteve të KfW dhe Znj. Lindita Sotiri, Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

➤ **QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT**

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”.

Qëllimi i projektit “Programi për infrastrukturën komunale V” është të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet në bashkitë e përfshira në program. Përcaktimi i tyre është bërë sipas prioriteteve të Masterplanit Kombëtar të Ujësjellës-Kanalizimeve, si dhe nevojës për investime për të përmbyllur investimet e kryera në fazat e mëparshme të programit. Konkretisht, vendndodhjet Lezhë, Fier dhe Sarandë kanë qenë pjesë e fazave të mëparshme I dhe II të programit, ndërsa vendndodhjet Berat, Kuçovë, Gjirokastrë, Kamzë dhe Lushnjë kanë qenë pjesë e fazave të mëparshme I, II, III e IV të programit.

Objektivi i programit është të kontribuojë në përmirësimin e në qëndrueshmërinë dhe aksesit që do të ketë popullsia e zonave të përfshira në program për ujin e pijshëm për kanalizimet dhe pjesërisht trajtimin e ujërave të përdorura, për tarifa të pranueshme të kostove, si dhe në përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve të bashkive të përfshira në program.

Nëpërmjet financimeve të parashikuara në kuadër të projektit “Programi për infrastrukturën komunale V” synohet përmirësimi i situatës së furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura në qytetet e përfshira në program, si dhe përmirësimi i treguesve të performancës për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve në bashkitë e përfshira në program.

Projektligji është i bazuar në Kushtetutë, në përputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe projektvendimi është miratuar në parim në Këshillin e Ministrave me vendimin nr.607, datë 11.9.2019.

Ky projektligj nuk përafrohet me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

➤ **EFEKTET FINANCIARE**

Me anë të kësaj marrëveshjeje, të dyja qeveritë bien dakord për dhënien e mundësisë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) një kredi të butë në vlerë të përgjithshme deri në 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro, një kontribut financimi për masa të nevojshme shoqëruese deri në vlerën 3 000 000 (tre milionë) euro, për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të sipërpërmendur, si dhe një kontribut financimi në vlerë të përgjithshme deri në 6 000 000 (gjashtë milionë) euro, i cili do të përdoret për investimin.

Projekti që do të financohet nëpërmjet kredisë dhe granteve si më sipër është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe, më konkretisht, në programin “Ujësjellës-Kanalizime”.

➤ **DISKUTIME NË KOMISION**

Pas prezantimit të projektligjit Komisioni kërkoi sqarime mbi zbatimin e fazave të mëparshme të projektit si dhe mbi targetimin e qyteteve ku do të zbatohet projekti.

Deputetë, anëtarë të komisionit u interesuan lidhur me efektet që mund të sjellë rishikimi i buxhetit të shtetit në vijimin e punës për ujësjellësin.

Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se fillimisht targetimi është bërë për 11 qytete, pro hartëzimi i saktë i tyre do të finalizohet pas auditimit të fazës së parë të projektit. Në lidhje me buxhetin, nga pala e ftuar u sqarua se në bazë të indikacioneve të para nuk pritet të ketë probleme lidhur me buxhetimin që i takon pjesës së ujësjellës kanalizimeve.

➤ **PËRFUNDIME**

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nën për nën dhe në tërësi dhe me të gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI